

**TESTI PROFESIONAL  
PROCEDURË CIVILE  
TEZA 15**

**1. A – Shpjegoni cilat janë rregullat për dëgjimin e dëshmitarëve:**

Rregulli i përgjithshëm është që dëshmitarët duhet të paraqiten në gjykatë në ditën dhe orën e caktuar nga gjykata dhe të dëgjoen prej saj në debatin gjyqësor.

- Në raste të veçanta, të parashikuara shprehimisht nga ligj dëshmia e dëshmitarëve bëhet jashtë ambjentëve të gjykatës këto. Këto raste të veçanta për dëgjimin e dëshmitarëve janë:

- Sëmundja e dëshmitarit e cila pamundëson paraqitjen në gjykatë;

- Dëshmia e Presidentit të Republikës kur ai e kërkon të pyetet në zyrën e tij; ajo e Kryetarit të Kuvendit; e Kryetarit të Këshillit të Ministrave dëshmia e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese ajo e kryetarit të Gjykatës së Lartë, të cilët me kërkesën e tyre mund të pyeten në selinë ku ushtrojnë detyrën. Nëse bazuar në rastet e veçanta dëshmitarët dëgjoen jashtë selisë së gjykatës, ato merren nga një anëtar i gjykatës para datës së seancës dhe dëshmia e tyre lexohet në seancën gjyqësore. Pyetja e dëshmitarëve bëhet gjithmonë në prani të palëve.

Dëshmitarit para dhënies së dëshmisë janë të (neni 236) detyruar të bëjnë betimin (neni 237).

**(7 pikë)**

**b– A mund të pyetet me cilësinë e dëshmitarit një person që nuk flet ose nuk dëgjon? Nëse po, si bëhet kjo gjë?**

Në rast se në cilësinë e dëshmitarit thirret një person që nuk flet ose dëgjon, pyetjen e tyre mund të bëhet me shkrim dhe dhe ata dëshminë e japin me shkrim. Në rast se edhe kjo dëshmi është e pamundur, gjykata thirret një person që i kupton shenjat e personit që pyetet si dëshmitar. (neni 218)

**(3 pikë)**

**2. Krahasoni procedurën e realizimit të letërporosisë me atë të marrjes së provave të të tretët.**

Ligji procedural përcakton që marrja e provave mund të bëhet me letër porosi. Letër porosia përcaktohet në ato raste kur prova duhet të merret jashtë teritorit të veprimtarisë së gjykatës. Në këto raste gjykata që gjykon çështjen ia delegon këtë kompetencë gjykatës së vendit ku ndodhet prova.

Në këto raste, nëse palët e gjykimit kërkojnë bashkërisht që për marrjen e kësaj prove të delegohet njëri prej anëtarëve të trupit gjykues ajo merret nga ky gjyqtar i gjykatës që gjykon çështjen.

Marrja e provave të të tretët bëhet gjithmonë nga gjykata që gjykon çështjen, e cila kur e kërkon njëra nga palët, gjykata urdhëron palën tjetër ose një person të tretë që të paraqesin në gjykim një dokument apo një send, kur kjo gjykatë e çmon të nevojshme.

Në rastin e marrjes së provës me letërporosi, dëshmia e marrë në këtë mënyrë fiksohet në një proces-verbal të veçantë, i cili i dërgohet gjykatës që gjykon çështjen, ndërsa në rastin e dytë të gjitha veprimet i kryen gjykata që gjykon çështjen.

**(10 pikë)**

3. a- Analizoni cilat janë shkaqet ligjore që nën nenin 465 “4” të KPC-së parashikohet shprehimisht “ Në gjykimin në apel nuk mund të paraqiten kërkime të reja, të shtohen apo të ndryshohen elementet e padisë”.

Gjykata e apelit e gjykon çështjen në bazë ankimi si gjykatë e shkallës së dytë Pra kjo verifikon ligshmërinë e vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, si nga pikëpamja e faktit ashtu edhe nga ana e ligjit.

Gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes objekt ankimi nuk mund të kapërcejë kufijtë e padisë fillestare të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë. Ajo si gjykatë themeli nuk mund të kalojë kufirin e gjykimit të gjykatës të shkallës së parë, pasi cënon parimin e dyshkallësisë së gjykimit dhe në këto raste ajo nuk është gjykata e caktuar me ligj për të gjykuar këto kërkime të reja apo elemente të reja të padisë, të cilat duhej të shqyrtohen në shkallën e parë.

(8 pikë)

- b- Si rregull, gjykata e apelit nuk mund të pranojë për shqyrtim fakte dhe prova të reja me përjashtim të rasteve të përcaktuara shprehimisht në ligj (neni 465 “5” i Kodit të Procedurës Civile). A është i zbatueshëm ky rregull edhe për pohimin gjyqësor dhe dhe jashtëgjyqësor?

Gjykata e apelit, bazuar në nenin 465.5, si rregull nuk pranon për shqyrtim fakte dhe prova të reja, përveç kur janë rastet e parashikuara nga gërmat: “a”, “b”, dhe “c” të kësaj pike (n.465.5) të KPr.C. Kjo procedurë nuk zbatohet për marrjen pohimit gjyqësor ose jashtë gjyqësor.

(4 pikë)

4. a- Argumentoni si e kuptoni shprehjen: “Nuk është në misionin e ekspertit të japë një mendim juridik”.

Është parim themelor i gjykimit civil që gjykata e zgjidh marrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. (N.16 K.Pr.C).

Nga ana tjetër, bazuar në nenin 224/a të K.Pr.C.gjykata mund të thërrasë një ose më shumë ekspert për konstatimin ose sqariminin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrveshjen në gjykim dhe vetëm kur për to kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës ose e artit.

Pra nga analiza dhe interpretimi i përmbatjes se neneve 16 dhe 224/a të K.Pr.C. arrihet në përfundimin se zgjidhja e çështjes objekt gjykimi bëhet në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, të cilët janë të detyrueshme për zgjidhjen e çështjes të cilat përcaktohen eskuzivisht vetëm nga gjykata .

Zbatimi i ligjit për zgjidhjen e çështjes është e drejtë dhe detyrim vetëm i gjykatës. Sipas parimit : “IURA NOVIT CURIA”. Detyra e ekspertit, bazuar ne nenin 224/a është vetëm të konstatojë e të sqarojë faktet e çështjes objekt mosmarrëveshjeje, por kursesi të çfaqë mendim juridik për zgjidhjen e çështjes (n.16 , 224/a ; 224/b (3)) .

Ekspertimi është thjesht një provë si gjithë provat e tjera, të cilat vlerësohen dhe çmnohen nga gjykata.

(8 pikë)

**b- Analizoni përse mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën dhe nëse gjykata vendos mospranimin e mendimit të ekspertit, shpjegoni si duhet të procedijë ajo më tej për zgjidhjen e çështjes në themel.**

Në gjykimin e një çështjeje përveç aspekteve ligjore për përcaktimin, interpretimin e normës juridike që duhet zbatuar për zgjidhjen e një mosmarrëveshje, objekt gjykimi, shpesh gjatë gjykimit përbëjnë objekt gjykimi edhe aspekte faktike, për të cilat gjyqtari nuk është as nuk mund të jetë ekspert. Këto aspekte fakti kanë nevojë të sqarohen për kryerjen e kësaj detyre kërkohe njohuri të posaçme në fusha të shkencës teknikës ose artit.

Për këto arsye gjykata, kur është e nevojshme vendos caktimin e një ose disa ekspertëve, të cilëve ajo u cakton detyra konkrete për të cilat ato duhet të japin mendimin e tyre të specializuar.

Ndonse sikundër përmendëm, në raste të veçanta mendimi i ekspertëve është i rëndësishëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes, ligji i parashikon (N.224/b K.Pr.C) se “mendimi i ekspertëve nuk është i detyrueshëm për gjykatën...”. Në këtë rast shtrohet pyetja: A ka kontradiktë në këtë pohim? Përgjigjja është jo. Argumenti ligjor është se mendimi i ekspertit është provë si të gjithë provat e tjera dhe ekspertimi si një nga llojet e provave të parashikuar nga kodi i proc. Civile nuk ka vlerë provuese të paracaktuar.

Gjykata në ushtrimin e funksionit të saj kushtetues për dhënien e drejtësisë është e detyruar të vlerësojë e të çmojë me kujdes vërtëtesinë e vlefshmërinë e çdo prove të administruar gjatë gjykimit, e në këtë kuptim nuk bën përjashtim as akti i ekspertimit si provë.

Megjithatë në rastë të veçanta akti i ekspertimit mund të jetë përcaktues në zgjidhjen e drejtë të çështjes, por megjithatë, kur gjykata konstaton se mendimi i ekspertëve vjen në kundërshtim më provat e tjera, gjykata mund të mos e pranojë atë, por në këto raste gjykata është e detyruar të arsyetojë me hollësi këtë mendim të saj në vendimin përfundimtar ose në një vendim tjetër që jep për këtë çështje gjatë gjykimit. Nga ana tjetër në këto raste, bazuar në nenin 229 të K.Pr.C., gjykata kryesisht ose me kërkesën e ndonjërës prej palëve, mund të kërkojë sqarime plotësuese nga ekspertët ose të urdhërojë një ekspertim të ri me kusht që të thërresë si ekspertë persona të tjerë

(10 pikë)

*Da shihet me 2 Kore*  
*[Signature]*